



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*, dëshmitari i 13-të i thirrur nga Prokuroria, ish-komandant i Zonës Operative të Llapit të UÇK-së Rustem Mustafa, përfundoi dhënien e dëshmisë të martën. Dëshmitari dëshmoi pa masa mbrojtëse dhe u mor në pyetje nga Prokuroria, Mbrojtja dhe gjykatësit.

Dëshmitari i 14-të i Prokurorisë, Francis Leduixh (Ledwidge) filloi dhënien e dëshmisë të martën. Z. Leduixh është oficer i ushtrisë britanike që ka shërbyer në Kosovë gjatë kohës përkatëse. Ai dëshmoi pa masa mbrojtëse.

Dëshmitari i 15-të përfundoi dëshminë sot paradite. Dëshmitari dëshmoi përmes videolidhjes me ndryshim të zërit dhe të pamjes, dhe u mor në pyetje nga ZPS-ja dhe gjykatësit.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 17 korrik, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Rexhep Selimi. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Selimi të pengojë ecurinë e procesit ose të kryejë vepra të tjera penale kundër atyre që konsiderohen se janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi apo mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritet të paraqiten në Gjykatë. Trupi Gjykses arriti në përfundimin se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, më 23 qershor, Trupi Gjykses vendosi të miratonte kërkesën e ZPS-së për pranimin e dëshmimeve me shkrim dhe provave materiale shoqëruese të dy dëshmitarëve, në vend që këta dëshmitarë të dëshmonin në sallën e gjyqit. Në vendimin e vet, Trupi Gjykses balancoi me kujdes nevojën për respektimin e të drejtave të të akuzuarit me nevojën për të siguruar shpejtësinë dhe efikasitetin e procesit. Trupi Gjykses konstatoi se dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit, kanë fushëveprim të kufizuar pasi të dy dëshmitarët qenë në Kukës për një periudhë të kufizuar kohore dhe deklarata është përsëritëse ose konfirmuese e dëshmimeve të dëshmitarëve të tjerë që Mbrojtja pati mundësinë t'i merrte në pyetje. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses gjykoi se paraqitja e këtyre provave sipas rregullës 153 nuk është mospërputhëse me të drejtat e të akuzuarit ose drejtësinë e gjyqimit.

Rregulla 153 e Rregullores së Procedurës dhe Provave mundëson që Trupi Gjykses të identifikojë situata në të cilat nuk është e nevojshme që dëshmitari të japë dëshmi në sallën e gjyqit me qëllim thjeshtimin dhe përsheptimin e procesit, duke ruajtur drejtësinë e gjyqimit.

Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për leje për apelimin e këtij vendimi për shkak se tashmë kishte shqyrtuar shumicën e argumenteve të paraqitura nga Mbrojtja në kërkesën e saj, në vendimin që kishte lëshuar më parë mbi këtë pikë. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se pranimi i deklaratave me

1





shkrim në vend të dëshmime gojore duhet të jetë “masë që përdoret si mjet i fundit” dhe vetëm kur është “rreptësisht e domosdoshme”, Trupi Gjykes konstatoi se Mbrojtja kundërshtoi rregullën 153 në përgjithësi. Duke marrë parasysh se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave është shqyrtuar nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese që ka konstatuar se nuk përbën shkelje të Kushtetutës së Kosovës, Trupi Gjykes gjykoi se mospajtimi me Rregulloren nuk mund të shërbejë si bazë për kërkesë për leje për apelimin e një vendimi.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykes miratoi kërkesën e Mbrojtjes në lidhje me zgjatjen e afatit për dorëzimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të veta nga 17 korriku deri më 16 gusht. Në të njëjtin vendim, Trupi Gjykes theksoi se nuk ndryshojnë datat e caktuara për konferencën përgatitore të Mbrojtjes dhe fillimin e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

Trupi Gjykes vendosi që paraqitja e provave nga mbrojtësi i viktimave dhe konferenca përgatitore e Mbrojtjes të bëhen ndërmjet 21 dhe 25 gushtit dhe data e synuar që Mbrojtja të fillojë me prezantimin e provave të saj është caktuar më 18 shtator 2023.

Ndër lajme të tjera, periudha e pushimit të DHSK-së do të fillojë të hënën, 24 korrik, dhe do të zgjasë deri të premten, 11 gusht 2023. Gjatë kësaj periudhe nuk mbahen seanca gjyqësore dhe disa nga shërbimet jothelbësore do të jenë në minimum. Gjithsesi, Gjykata mbetet plotësisht funksionale dhe puna vazhdon në të gjitha seksionet e DHSK-së. Gjatë pushimit mund të dorëzohen parashtrime dhe, vetëm në rast se gjykatësit kanë urdhëruar ndryshe, afatet gjyqësore vazhdojnë të jenë në fuqi. Nuk do të ketë informim javor për median gjatë pushimit të Gjykatës, që do të thotë se informimi javor i ardhshëm për median është planifikuar për të enjten, 17 gusht, në orën 14:30.

### **Pyetje nga gazetarët**

